



Npi – 01/100 datë: 29.04.2022

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/114 të datës: 26.04.2019, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më: 29.04.2022 është nxjerrë ky:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I M B L E D H J E S S Ë - I V - T Ë R R E G U L L T T Ë K U V E N D I T T Ë K O M U N Ë S S Ë S H T I M E S
E mbajtur më: 29.04.2022, (e premte) në ora 9.^{oo} h. në sallën e Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi i Kuvendit: z.Adnan Ademi, Anëtarët e Kuvendit: Rrahman Jakupi, Perparim Ramusa, Lumni Amrush, Besartë Musliu-Spahija, Adem Ramadani, Hasan Avdyli, Hamëz Tërshani, Albana Podvorica, Adelina Beqaj, Besnik Seferi, Gëzim Haxhiu, Reshat Mujota, Asllan Beqaj, Shkurte Mustafa, Sanije Sadiki, Heroina Selmani, Kadri Emini, Rrezartë Ramadani, Muhamet Ademaj, Rexhep Gashi.

Në mbledhje përveç anëtarëve të Kuvendit kanë marrë pjesë edhe: Drejtorët, z.Bujar Ferati, nga ZKF-ja ; z.Lulzim Muharremi, nga Zyra Ligjore; z.Reshat Gashi, nga zyra për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore; z.Egzon Ahmeti, nga OJQ "YHR"; z.Gazmend Ademaj, dhe Shpëtim Gashi nga Zyra për Informim; z.Muhamet Hoxha, nga Radio Zëri i Shtimes; z.Agim Ademi, nga Koha Ditore; znj.Valmira Hoxha, praktikante; Si dhe dia qytetarë të interesuar.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit Konstattoj, Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit më 07.04.2022,
2. Pyetje Përgjigje,
3. Raporti tre mujor buxhetor Janar-Mars 2022,
4. Propozim-Vendim për bartje të mjeteve nga kategoria e rezervës në projekte kapitale,
5. Rishqyrtimi i Rregullores Komunale për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha për 2022, Npi-01-70, sipas kërkesës të MAPL, Nr.04-416 dt. 5.04.2022,
6. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit, Npi-01-56 për rizgjedhjen e Komitetit për Arsim, Kultur, Rini dhe Sport , sipas kërkesës të MAPL, Nr.020-284-4-2022, dt.13.04.2022,
7. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit, Npi-01-57 për rizgjedhjen e Komitetit për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale, Ambient dhe Shërbime Publike, sipas kërkesës të MAPL, Nr.020-284-3-2022, dt. 13.04.2022,

8. Propozim-Vendim për Themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për KRM “Pastërtia” SHA Njësia në Shtime,
9. Propozim-Vendim për caktimin e lokacioneve për Qerdhe në fshatrat Godanc i ulët dhe Petrovë,
10. Propozim-Plani Lokal i Verprimit për Biodiversitet 2021-2026,
11. Informatë e përgjithshme nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik,

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Përparim Ramusa; Përshëndetje, pajtohem me pikat e rendit të ditës, dhe sygjerojmë të vazhdojmë.

z.Reshat Mujota; Përshendetje, pajtohem me rendin e ditës me përjashtim pika e 9 të cilën propozoj që të hiqet nga rendi i ditës, edhe pse jam për ndërtimin e çerdheve por i keni propozuar pa projekt, u kanë mirë që me pas projektin. Në Petrovë është propozuar ndarja e një parcele ku ka varreza prandaj unë propozoj që kjo pikë të shtyhet me qëllim që të gjindet një parcelë tjetër.

z.Përparim Ramusa; Në këtë pikë pajtohem me Reshatin, por ne menduam për me diskutu për këtë pikë për me argumentu se e kanë gabim.

z.Besnik Seferi; Përshendetje, sa i përket pikave të rendit të ditës duhet ti shqyrtojmë dhe të diskutojmë këtu brenda Kuvendit, kështu që unë jam për këto pika.

z.Reshat Mujota; Unë e dhashë vetëm si propozim le të vendos Kuvendi për cilin version është.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi, Kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, me 20 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim” aprovoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit më 07.04.2022

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Adem Ramadani; Përshendetje, një pyetje që e kam bërë për këshillat e fshatrave, nuk ja kam parashtruar Kryetarit por Kryesusit të Kuvendit?

z.Rrahman Jakupi; Përshendetje, unë kam dy vërejtje, e para ka të bëjë me gabimet drejtëshkrimore, në 5 faqe janë 56 gabime drejtëshkrimore, mendoj se duhet me pas parasysh pak qështjen e drejtshkrimorit që të bëhet qysh duhet, sepse ndoshta edhe një nxënës i klasës së 5 ose 6 kishte me shkruar më mirë. E dyta te faqja 4 Zyrtari Ligjor, nuk është përmendur fare në procesverbal që lidhur me Rregulloren për Taksa Ngarkesa dhe Gjoha është përmendë që në kohën e Rrahman Jakupit, me siguri që zyrtari ligjor ka menduar në mandatin tim, sepse nuk mund me bë dallimin në mes mandatit dhe kohës është votuar një dokument me dy vota “për” kështu që të ceket ky diskutim i tijë dhe të përmendet emri im në procesverbal, faleminderit.

z.Idajet Rexhepi, Zyrtar i Kuvendit; Përshëndetje, unë nuk po di se çka duhet të përmirësohet në procesverbal, sepse realisht as unë e as ju nuk e mund ta dini se çka ka menduar Zyrtari Ligjor, kur e ka thënë në kohën e Rrahman Jakupit.

z.Rrahman Jakupi; Të dëgjohet Stenogrami, dhe në faqen nr.4 të procesverbalit të shënohet Stenogrami i Zyrtarit Ligjor, sa i përket diskutimit për Rrahman Jakupin.

“Citim nga Stenogrami” z.Lulzim Muharremi, zyrtar ligjor; “Sipas nenit 48 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, propozimi i Rexhep Gashit, kalon sepse votat abstenim nuk ndikojnë në rezultatet e votimit por janë vetëm për të konstatuar kuorumin, pra kjo është. Ka qenë edhe një rast i tillë në Kuvend kur në të njëjtën mënyrë e keni kalu, nën kryesimin e Rrahman Jakupit. Me falni se tani e gjeta, dmth sipas nenit 48.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, për ata që dojnë me ditë më mirë”.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi, Kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, unanimitisht miratoi Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit më 07.04.2022, me vërejtjet.**

Pika 2

Pyetje Përgjigje

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Muhamet Ademaj: Kamë këto pyetje, 1.Pyetje për DKA-në pse te shkolla e mesme Profesionale nuk ka ujë? 2. Pyetje për DSHP-në kur do të riparohen gropat nëpër rrugë? 3. Pyetje për DSHMS-në pse nuk po funksionon punkti shëndetësor në Petrovë?

z.Reshat Mujota: Kamë këto pyetje:1. Pyetje për DKA-në pse një Çerdhe për fëmijë është mbyllur, e ndërkohë na vjen një kërkesë për një Çerdhe të re?

z.Lumni Amrushi: Kamë këto pyetje: 1. Pyetje për DPUKGJ-në pse ende nuk ka filluar projekti i asfaltimit i rrugës në Pjetershticë, si dhe rregullimi i trotuarit dhe ndriqimit në këtë fshat? 2. Pyetje për DSHMS-në, pse nuk po bartet laboratorit në ambulancën e Pjetershticës, por po rrinë në Shtime? 3. Pyetje për DZHE-në – Sektori i Bujqësisë, kur do të bëhet thirrje për ndarjen e Subvencioneve?

z.Besnik Seferi: Kamë këto pyetje: 1. Pyetje për DPUKGJ-në kur do të bëhet asfaltimi i rrugës për në fshatin Topillë, sepse është projekt i premtuar? 2. Pyetje për DKA-në, kur do të zgjidhet problemi i transportit të nxënësve-fëmijëve në fshatin Mollopolc?

znj.Albana Podvorica: Kamë këto pyetje: 1. Pyetje për DPUKGJ-në, në një pjesë të rrugës “Skender Salihaj” nuk ka trotuar dhe po rrezikohen nxënësit, a ka drejtoria plan për rregullimin e trotuarit në këtë rrugë?

z.Hasan Avdyli: Kamë këto pyetje: 1. Pyetje për DSHMS-në unë po shprehi një shqetësim për ndërprerjen e kontratës për zyrtarët që merren me ndihmën e personave në nevojë. Kërkoj që vendimarrësit të dalin në vendin e ngjarjes dhe të shikojnë, sepse ka familjarë që jetojnë në kushte të mjerueshme dhe pastaj të vendosin për rastin, pyetja është pse janë ndërpre shërbimet e DSHMS-së për këtë kategori dhe çfarë ndihma keni menduar për këta?

znj.Besartë Musliu-Spahija: Kamë këto pyetje: 1. Pyetja për DPUKGJ-në, në rrugën “Skender Salihaj” që lidhë qytetin e Shtimes me lagjen Ademaj dhe fshatin Mollopolc, kur do të bëhet rregullimi i ujëmbledhësit përballë Shtëpis së Kulturës, rregullimi i asfaltit te trafostacioni i KEDS-it, rregullimi i gropës te fusha e sportit dhe rregullimi i rrugës që lidhet me biznesin “Maksiti”?

z.Përparim Ramusa: Kamë këto pyetje: 1. Pyetje për Kryetarin, si e ndien vetin Kryetari, meqenëse ka premtuar autostradë, unazë të madhe dhe të vogël, kur qe 5 muaj nuk ka mundësi me e rregulluar rentgenin në QKMF, kjo nuk ka ndodhur që nga paslufta?

z.Rexhep Gashi: Kamë këto pyetje: 1. Pyetje për DPUKGJ-në pse nuk po rregullohen disa shenja dhe tabela të Komunikacionit në disa rrugë ashtu qysh kemi bërë pyetje më heret? 2. Pyetje për DPUKGJ-në a është pranuar teknikut paralelja e ndarë e shkollës fillore “Lasgush Poradeci” në Gjyrkovc dhe pse nuk është funksionale?

z.Hamëz Tërshani: Kamë këto pyetje: 1. Pyetje për Kryetarin, Parku i qytetit - pishat është duke u shkatërruar dita ditës aty po dëmtohen pemët po vjedhen paisjet lodrat e fëmijëve, ulëset etj. a është ndërmarrë diçka në lidhje me këtë? 2. Dhe pyetja tjetër për Kryetarin, pse mungon ndriçimi rreth stazave të ecjes, rreth pishave pse nuk është funksional ndriçimi? 3. Dhe pyetja tjetër për Kryetarin, është rrezik për qytetarët nga qenët endacak çka është ndërmarrë në lidhje me këtë pikë?

znj.Adelina Beqaj: Kamë këto pyetje: 1. Pyetje për DZHE-në, Komuna bashkë me organizatën “Help” kanë ndarë 22 kontrata, në bazë të cilave kriteret janë përzgjedhur ato? 2. Pyetje për Kryetarin pse nuk po finalizohen projektet kapitale? 3. Pyetje për Kryetarin, rruga për te Çerdhja dhe në shkollën te Gjijnazi, pse është punu në atë formë sepse është mjaft keq dhe rrezik për nxënës, a keni në plan ta përmirësoni?

z.Rrahman Jakupi: Kamë këto pyetje: 1. Pyetje për Administratë, a është e vërtetë që ju nuk i kontrolloni fare vendimet nga aspekti ligjor? 2. Pyetje për ekzekutivin, a keni bërë shkelje që keni bërë shkarkimin e punëtorëve pa paralajmërim ose degradimin për punëtorët shëndetësor?

Kryetari, z.Qemajl Aliu; Përshëndetje, rruga në fashtin Topillë, është një projekt që ka filluar para 3 viteve. Pronari i kompanisë që e ka punuar këtë rrugë ka thënë se nuk kam më parë, sepse lejislatura e kaluar i ka paguar të gjitha parat. Ky problem tani po diskutohet për të bërë një zgjidhje me një projekt shtesë. Sa i përket rentgenit në QKMF është një donacion nga qeveria Japoneze, për të cilin kemi marrë informatë se nuk është futur në listën e servisimit. Na vjen keq që ky defekt nuk po mundë të rregullohet shpejt ka dyshime se është bërë prishje e qëllimshme. Po ashtu ka dyshime se sabotimi në QKMF ka filluar nga dorëheqja arbitrare e ish drejtoreshës. Shkarkimi i stafit menaxherial në QKMF ka ndodhur pas konstatimit të një gjendje mjeruese në QKMF edhe nga ana e auditorit me raportin e tij, kështu që ne kemi marrë masa mbi bazën e këtij raporti kemi marrë masa për shkarkimin e stafit menaxherial. Sa i përket premtimeve për ndërtimin e unazave do të shihet së shpejti. Ndërsa sa i përket atostradës do të fillojë në mandatin tonë qeverisës. Sa i përket rrugës për të qerdhja e re e fëmijëve ju e dini se që shumë vite është një rrugë e tillë me rrezikshmëri të lartë, sepse andej kemi kaluar të gjithë. Aty është një kompani "Kopshti" e cila ka falimentu dhe ka ikur, që realishtë ju e keni falimentuar, dhe tani ne duhet me e tenderuar rishtazi këtë punë. Kjo rrugë do të rregullohet për nxënë, dhe secila nënë do të shkojë komodë te fëmija i saj në qerdhe.

z.Përparim Ramusa; Kryetar, nuk je këtu në zyren e vetëvendosjes por në Kuvend. Unë jam krenar me Fehmi Mujotën që e ka ndërtuar rrugën për fshatin Topillë.

Kryetari, z.Qemajl Aliu; Unë paraqitem në Kuvend si Kryetar i Komunës së Shtimes, por sigurishtë nuk paraqitem ashtu si kërkon ti. Ti po e paraqet në Kuvend pyetjen e PDK-së, e cila përveq të tjera me 50 mijë euro ka kosit bari në kohën elektorale.

znj.Adelina Beqaj; Po më kujtohet një fjalë e Albin Kurtit kur thojke "Mos u zgërdhi" e ti po zgërdhihesh e nuk po përgjigjesh, ty qytetarët të kan votuar për gjithëqka por jo për me u ankuar. Unë po bëjë pyetje e ti nuk po përgjigjesh.

Kryetari, z.Qemajl Aliu; Faleminderit për fjalorin, mirë që pe kujton Albin Kurtin sepse sa herë e kujton ke mundësi me u korigju dhe përmirësuar, ndërsa qytetarët e komunës së Shtimes janë shumë krenarë për ndryshimin që e kanë bërë me votë dhe kanë me qenë çdo ditë e më shumë edhe më krenarë me punët tona, gjithë ata e po besoj edhe ju.

z.Hamëz Tërshani; Përshëndetje edhe një her Kryetar, sa po ma konfirmove vetë se mundesh me qenë doktorrë i mirë, por menaxher i dobët. Hala nuk je i vetëdijshëm për detyrat, pyetja ime ishte shumë e qartë për punët që janë duke u bërë, pyetja ke për mirëmbajtje, Ekzekutivi, i mëhershëm ka arritur me ndërtuar e ju nuk po jeni në gjendje me i mirëmbajt, sepse ato duhet me u pastruar kjo është puna e drejtorisë. Ti Kryetar ki mungesë të hatashme të njohurive në Komunë.

z.Besnik Seferi: Unë po kërkojë që pyetjet të dërgohen me shkrim në sekretarinë e Kuvendit sepse diskutimet po stërgjaten.

Kryetari, z.Qemajl Aliu; U hodhën këtu disa konkluzione, edhe fyrye në adresën time, kjo le të mbetet në nivelin dhe kulturën tuaj, Hamëz, kamë dashur me të kursyer për shkak të statusit tëndë si veteranë i UÇK-së, përndryshe konkluzionet tua si padituria, paaftësia ato nuk kanë të bëjnë me emrin tim, koha e ka dëshmuar. Për të gjithë qytetarët e komunës së Shtimes dua ta jap një sçarim, se nga 24 Dhjetor deri më 31 Mars, edhe për shkak të kushteve të këqija në Republikën e Kosovës, është mbyllja e vitit fiskal, kështu që investimet kapitale fillojnë, përpunohen dhe fillojnë të punohen diku në fillim të muajit Prill. E di që e keni shfrytëzuar në formën mediale dhe keni bërë propagandë, se nuk ka investime, se nuk po fillojnë projektet, projektet nuk fillojnë jo vetëm në komunën e Shtimes por në asnjë komunë tjetër të Republikës së Kosovës nuk fillojnë para muajit Prill. Se projektet fillojnë nga 1 prilli, këtë sçarim po e jap për qytetarët e Komunës së Shtimes. Për sa i përket Kontratës që ka qenë në drejtorinë tënde Hamëz, që ke kosit bari 90 mijë euro për dy muaj e që na i ke lënë borgj rreth 200 mijë euro, me këtë nuk duhesh të ndihesh krenarë, por duhet me pas turp, dhe

për këtë të jesh i bindur se nëse ka prokurori efikase, ti me krejt punëtorët e tu që keni abuzuar me atë duhet me dhënë përgjegjësi, më vjen keq.

z.Përparim Ramusa: Në emër të grupit të partisë demokratike deri sa Kryetari mban fjalim politik, e përmend Kryeministrin Albin Kurtin, dhe ish drejtorin e etiketon për keqpërdorim thot se duhet me ardhë prokurorija me hetu, qysh mos me reagu, deri sa je parimor je Kryetar e jo këshilltar, qajo akuzë e jotja, ke më e madhe se sa e Kryetarit, është Kuvend këtu, kështu që vërejtja ma së pari është për Kryetarin, sepse nëse dojmë debat të tillë bëjmë, nëse dojmë debat profesional atëher bëjmë debat profesional.

z.Kadri Emini; Përshendetje, mu për këtë arsye unë në takimin e paë të këtijë Kuvendi unë kam kërkuar që kjo pikë mos me qenë fare si pikë e rendit të ditës. Të jeni të bindur se kjo pikë nuk i kontribon dhe nuk janë në interes të qytetarëve dhe nuk i kontribojnë bashkëpunimit.

z.Rrahman Jakupi: Me datën 28.01.2022 është një dokument në të cilin thotë se nuk ka pasë parregullësi financiare, është nënshkrimi juaj në dokument që ua ka dërguar Thesari. Për këtë arsye qasja e juaj Kryetarë është e gabueshme sepse jeni Kryetar edhe i atyre 50% që nuk ju kanë votuar.

z.Reshat Mujota: Kryetari ka fol boll, e lus Kryesuesin që ti përmbahet rregullorës unë e respektojë për Kryetarë në zyre, ndërsa në Kuvend është i barabartë.

Pika 3

Raporti tre mujor buxhetor Janar-Mars 2022

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Para se të hapi diskutimin për këtë pikë e lexoi rekomandimin e KPF-së, në vazhdim fjalën ja dha Bujar Feratit për prezantimin e kësaj pike.

z.Bujar Ferati, zyrtarë kryesor financiarë ; Përshendetje, ne e kemi të obliguar me ligj raportimin tre mujor financiar. Te pjesa e të hyrave jemi pak më keq mirëpo besojë do ta përmirsojmë edhe pjesën e të hyrave. Në vazhdim ky lexoi dokumentin sipas kategorive buxhetore (shih dokumentin financiar), besoj se dokumentin e keni lexuar, unë jam këtu për tu përgjigjur nëse ka ndonjë pyetje .

znj.Adelina Beqaj; Kërkojë falje për zhurmën që e shkaktova nuk më jeni përgjigjur në pyetjen që e kam bërë për shpenzimet në zyren e Kryetarit .

Kryetari, z.Qemajl Aliu; Shpenzimet në zyren e Kryetarit janë zero, dhe përgjigjen e dha ZKF-ja.

z.Përparim Ramusa; Dihet që kur nuk punon edhe nuk hargjon. Shqetësues është fakti se të hyrat vetanake i kemi me -1%.

z.Muhamet Ademaj; E falenderojmë zyrtarin për raportin sepse është përgaditur mirë. Siq po shihet deri më tani janë shpenzuar 25% të mjeteve . Krahasimi është -1% te të hyrat vetanake më të vogla ky është një shqetësim për ne të gjithë por po shpresojmë se do të rriten të hyrat deri në formë të vitit ne do ta mbështesim këtë raport.

z.Rexhep Gashi; Përshendetje për ZKF-në, te inkasimi i të hyrave vetanake me -1% kur i kemi pas disa probleme lidhur me pandemin covid-19 si dhe me kriza ekonomike, unë mendojë se ka qaluar enkasimi i të hyrave vetanake mirëpo unë mendojë se nuk jemi shunë keq dhe besojë se kjo do të përmirsohet.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi, Kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

Kuvendi i Komunës, unanimisht miratoi, Raportin Financiar të Komunës së Shtimes për tre mujorin e parë Janar-Mars 2022.

Pika 4

Propozim-Vendim për bartje të mjeteve nga kategoria e rezervës në projekte kapitale

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Fjalën ja dha Bujar Feratit për prezantimin e kësaj pike.

z.Bujar Ferati, zyrtarë kryesor financiarë ; Unë kërkojë që ky propozim vendim të miratohet nga Kuvendi. Dokumentin e keni marrë me kohë dhe e keni lexuar, mirëpo unë po ua lexojë 5 projektet për të cilat kemi kërkuar bartjen e mjeteve,. Në vazhdim lexoi dokumentin, (shoh dokumentin).

z.Përparim Ramusa; Unë kam diskutuar edhe në KPF dhe kam dhënë mendimin tim. Propëzoj që Kuvendi ta votojë këtë pikë.

znj.Rrezartë Ramadani; Përshendetje, ne si LDK-AKR e përkrahim këtë propozim vendim për bartjen e mjeteve financiare nga rezerva në projekte kapitale, dhe i ftoj anëtarët e Kuvendit që ta votojnë.

z.Besnik Seferi; Vërtet është bërë një sqarim dhe një specifikim i mirë për bartjen e këtyre mjeteve dhe e përgëzoj zyrtarin kryesorë financiarë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi, Kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

***Kuvendi i Komunës, unanimitisht miratoi, vendimin për destinimin e Rezervës Buxhetore Komunale, në riemërtimin e projekteve kapitale.**

Pika 5

Rishqyrtimi i Rregullores Komunale për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha për 2022, Npi-01-70, sipas kërkesës të MAPL, Nr.04-416 dt. 5.04.2022

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Përparim Ramusa; Ne po themi që kjo rregullore të rregullohet sipas kërkesës së MAPL-së dhe të kalojë.

z.Besnik Seferi; Edhe unë kërkoj që të vazhdohet tutje duke e harmonizuar me rekomandimin e Ministrisë.

z.Rexhep Gashi; Edhe ne jemi për, por që të harmonizohet me kërkesën e Ministrisë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi, Kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, unanimitisht miratoi, ndryshimet në Rregulloren Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2022, Npi – 01/70 datë: 07.04.2022, si vijon:**

Neni 13 i Rregullores Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2022, Npi – 01/70, ndryshohet sipas rekomandimit të MAPL-së dhe bëhet si vijon: "Mospagesa për shfrytëzimin e pronës Komunale parasheh masën ndëshkuese, ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë për personat fizik, ndërsa për personat juridik mund të parashihet vetëm sanksioni kundërvajtës me gjobë, sipas legjislacionit përkatës në fuqi për kundërvajtjet, respektivisht neni 29 (paragrafit 4 dhe 5) të Ligjit Nr.05/L-087 për Kundërvajtjet".

Pika 6

Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit, Npi-01-56 për rizgjedhjen e Komitetit për Arsim, Kultur, Rini dhe Sport , sipas kërkesës të MAPL, Nr.020-284-4-2022, dt.13.04.2022

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Para se të hapi diskutimin për këtë pikë lexoi kërkesën e MAPL-së për rishqyrtimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/56. Në vazhdim hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Përparim Ramusa; Unë propozoj që të marrim një pauzë me qëllim që të kordinohemi, dhe ta votojmë këtë pikë në pako.

z.Rrahman Jakupi; Siq dihet kemi Komitetet e përhershme, Komitetet tjera dhe Komitetet Konsultative. Unë mendoj se përfaqësues nga jashtë duhet me pas vetëm Komitetet Konsultative.

z.Lulzim Muharremi, zyrtarë ligjor; Përshendetje, neni 14 i Udhëzimit Administrativ të (MPL) Nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë thotë: "1.Komitetet e tjera të cilat themelohen nga Kuvendi i Komunës në fusha të caktuara përbëhen nga anëtarët e kuvendit dhe përfaqësuesit jashtë Kuvendit të Komunës që janë ekspert të fushave përkatëse . 2. Shumica e anëtarëve të komiteteve tjera përbëhen nga anëtarët e kuvendit si dhe duhet të reflektojnë përbërjen e Kuvendit të Komunës. 3. Anëtarët e komiteteve tjera nuk kanë të drejt të jenë më shumë se në një komitet. 4. Numri i anëtarëve në një komitet duhet të jetë më së shumti 5 anëtarë." E që duhet të zbatohet.

z.Reshat Mujota; Kur flasim për Komitetin për Arsim dhe Komitetin për Shëndetësi të cilat nuk janë Komitete obligative nuk po e kuptojë pse kto Komitete duhet me pasë ekspertë të jashtëm. Nëse flasim për formimin edhe të një Komiteti tjetër, athëherë fjala është për ti marrë 50 € meditje unë mendojë se kjo nuk është përfaqësim por vetëm interes.

z.Lulzim Muharremi, zyrtarë ligjor; Neni 15 pika 3 i Udhëzimit Administrativ të (MPL) Nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë thotë: “Anëtarët e komiteteve tjera paguhën për gjashtë (6) mbledhje të cilat mbahen brenda viti”.

z.Besnik Seferi; Unë po quditem me zyrtarin ligjor, që sot po na interpreton ligjin e në mbledhjen e mëparshme jo. Unë pajtohem për me u tërhek nga Komiteti. Te puna e Reshatit që tha është për ti marrë 50 € meditje, unë mendojë se mundë ti ndihmojmë dhe kontribojmë në mbledhjet e Komitetit. E përkrahu propozimin që u kërkua një pauzë prej 10 minutash me qëllim që të merremi vesh.

z.Lulzim Muharremi, zyrtarë ligjor; Sa i përket formimit të Komiteteve keni punuar mbi bazen e një marrëveshje politike, dhe nuk keni pyetur për aspektin ligjor, kështu që unë nuk e marrë fjalën vet por vetëm kur e kërkon Kryetari ose kur ma jep fjalën Kryesuesi.

z.Reshat Mujota; E kam një pyetje për Besnikun a mundemi me e shty këtë pikë apo është e domosdoshme me bërë tash Komitetet e prapë me na u kthy nga Ministria, të lutem ama përgjigjen?

z.Besnik Seferi; Neni 14 i Udhëzimit Administrativ të (MPL) Nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë thotë se: Komitetet tjera duhet të ken 5 anëtarë dhe duhet ta ken një ekspert të jashtëm. Ekspertë mundemi bërë nga jashtë pse jo.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Dha 10 minuta pauzë në ora 11:30h.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Mledhjen e vazhdoi në ora 11:59h.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi, Kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

***Kuvendi i Komunës, unanimisht vendosi që të shtyhen për shqyrtim pika e 6 dhe 7 e rendit të ditës për mbledhjen e radhës.**

Pika 7

Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit, Npi-01-57 për rizgjedhjen e Komitetit për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale, Ambient dhe Shërbime Publike, sipas kërkesës të MAPL, Nr.020-284-3-2022, dt. 13.04.2022

***Kuvendi i Komunës, unanimisht vendosi që të shtyhen për shqyrtim pika e 6 dhe 7 e rendit të ditës për mbledhjen e radhës.**

Pika 8

Propozim-Vendim për Themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për KRM “Pastërtia” SHA Njësia në Shtime

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

znj.Sanie Sadiki; Përshendetje, në emër të LVV ne e propozojmë për anëtarë të Komisionit z.Beqir Hoxha.

z.Muhamet Ademaj; Ne si koalicion LDK-AKR e propozojmë z.Fisnik Bunjaku.

z.Përparim Ramusa; Ne si PDK e propozojmë z.Bajram Hajrizi.

z.Reshat Mujota; Propozimin e Sanijes nuk po e di unë se kush është ky person. Unë e propozojë Besnik Seferin nga Vetëvendosja.

z.Besnik Seferi; Unë pajtohem me propozimin e Reshat Mujotes.

z.Përparim Ramusa; Pajtohem me Reshatin, por nuk po e di sa ka po i dalin këto pazare, neve as që na kan thirrur me u konsultuar për këtë pikë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Është e vërtetë që nuk ju kam fluar në konsultime sepse edhe më parë kur jemi konsultuar nuk e keni mbajtur fjalën. Unë në vazhdim po e qes në votim propozimet që u dhanë dhe konstatoi, Kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

* **Kuvendi i Komunës, me 10 vota “Për” me 11 vota “Kundër” dhe me 0 votë “Abstenim” nuk e miratoi propozimin e që z.Beqir Hoxha të jetë anëtarë i Kmoisionit.**

* **Kuvendi i Komunës, me 10 vota “Për” me 11 vota “Kundër” dhe me 0 votë “Abstenim” nuk e miratoi propozimin e që z.Fisnik Bunjaku të jetë anëtarë i Kmoisionit.**

* **Kuvendi i Komunës, me 11 vota “Për” me 10 vota “Kundër” dhe me 0 votë “Abstenim” miratoi propozimin e që z.Bajram Hajrizi të jetë anëtarë i Kmoisionit.**

* **Kuvendi i Komunës, me 11 vota “Për” me 8 vota “Kundër” dhe me 2 vota “Abstenim” miratoi propozimin e që z.Besnik Seferi të jetë anëtarë i Kmoisionit.**

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi se Kuvendi zgjodhi anëtarët e Komisionit si vijon: z.Bajram Hajrizi, z.Besnik Seferi dhe z.Bedri Zeqa.

Pika 9

Propozim-Vendim për caktimin e lokacioneve për Qerdhe në fshatrat Godanc i ulët dhe Petrovë

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

znj.Adelina Beqaj; Sa i përket kësaj pike ky diskutim ka qenë i shpejtë, Kryetari Qemaj Aliu la thirrur vetëm asambleistin Asllan Beqaj, ndërkaq mua nuk më ka thirrë. Sa i përket diskutimit publik, pak ka pas qytetarë. Ne e kemi parë se te lokacioni i propozuar nga drejtorja ka kundërshtime sepse aty ka varreza. Pikërisht për këtë arsye unë propozoj që kjo pikë të shtyhet me qëllim që të gjindet një lokacion tjetër. Projektin e përkrahim por dëshirojmë që ta kemi ose ta gjejmë një lokacion të duhur.

z.Asllan Beqaj; Ne kemi organizuar një debat publik me banorët e fshatit Petrovë për lokacionin e Çerdhes, më datën 3 Prill 2022, së bashku me banorë kemi dalë në vendin e ngjarjes dhe e kemi shikuar bashkërisht, banorët kanë thënë se aty në atë lokacion ka pasë varreza. Unë mendoj se ne duhet prapë të dalim në atë lokacion dhe të shohim pjesën se ku nuk ka varreza, me qëllim që ta gjejmë lokacionin e duhur për Çerdhe.

z.Përparim Ramusa; Në parim unë jam për aprovim. Mirëpo në Petrovë unë mendoj se duhet me dhënë sqarimet e nevojshme sepse në atë lokacion ka varreza, dhe une nuk e di pse Drejtori me e sjellë në Kuvend një propozim të tillë. Për këtë arsye unë propozoj që kjo pikë të shtyhet me qëllim që në Kuvend të sillen shenimet e sakta dhe tek pastaj të vendosim.

z.Reshat Mujota; Këtu dikush po thotë ka varreza e dikush po thotë nuk ka varreza, kujt me i besu. Unë jam që projektin për Çerdhe ta përfitojmë, por që probleme të tilla me lokacion nuk duhet me pasë, kështu që nëse dikush thotë që aty ka varreza unë nuk do ta votojë e mira është që këtë pikë me u shty për mbledhjen e radhës dhe me u përgadit më mirë.

z.Asllan Beqaj; Ne nuk jemi tu thënë që Çerdhja të ndërtohet te parcela ku ka varreza, por është një pjesë e parcelës ku nuk ka varreza prandaj unë po them që ta shikojmë bashkërisht se ku nuk ka varreza dhe aty të ndërtohet.

z.Reshat Mujota; Mua personalisht më ka pelqyer premtimi i Qemaj Aliut për me e hjekë Entin Special sepse është në interes të qytetarëve e i cili ka të bëjë edhe me imazhin e Komunës tonë. Sa i përket Çerdhes unë jam “kundër” edhe me qenë afër. Unë nuk e qoj fëmijën tim në atë Çerdhe ku varrezat shihen nga dritarja. Unë jam për por jo në këtë mënyrë dhe jo në atë vend ku po thotë Asllani, sepse unë vetë tash me shku aty i gjejë së paku tri varreza.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; I dëgjuam kolegët në diskutimet e tyre, mendoj se është shumë e rëndësishme që këtë projekt mos me humb por që sa më parë ta gjejmë një lokacion të përshtatshëm dhe ta aprovojmë këtë vendim.

z.Rrahman Jakupi; Sa i përket propozimit për Çerdhe në Petrovë unë mendoj se është dashur të diskutohet edhe për Çerdhen në Muzeqinë sepse është ngendër ku përfshihen disa fshatra. E sa i përket diskutimit publik aty kan marrë pjesë vetëm nja 2-3 vetë, të Vetëvendosjes e që nuk e kanë ditë fare se qka po diskutojnë. I përmenda të gjitha këto të meta, që realisht kjo duhet të lidhet me numrin e popullsisë. Fshati Godanc është afër Shtimes kështu që më mirë është që Çerdhja të ndërtohet në fshatin Muzeqinë sesa në Godancë. Ne jemi për ndërtimin e këtyre objekteve duke marrë parasysh kriteret që i thamë.

Kryetari, z.Qemajl Aliu; Është pak e quditshme se si projektet për Çerdhe të fëmijëve nuk mirëpritën, kjo është skandaloze nga ana juaj. Unë kam premtuar ndërtimin e 4 Çerdheve në Komunës e Shtimes. Çerdhja e parë është në fshatin Muzeqinë e cila është në procedurë ku do të përfshihen edhe fshatrat përreth. Çerdhja e dytë që do të ndërtohet është e planifikuar në fshatin Petrovë, dhe Çerdhja e tretë është planifikuar në fshatin Godanc i ulët ku do të përfshihen Godanci i epërm dhe një pjesë e lagjes së Pajtimit. E katërta do të diskutohet në Kuvend. Jam plotësisht dakord që të shterret debati për sa i përket ndërtimit të Çerdhes në Petrovë, për këtë arsye e kam autorizuar Kryetarin e fshatit Alban Rashitin për me organizuar debat me banorët e fshatit sepse ata e dijnë më së miri se ku duhet të ndërtohet Çerdhja e tyre. Edhe një herë po them se Shtimja do ti ketë 4 Çerdhe.

z.Përparim Ramusa; Nuk është mirë me na mbajtë moral politik, sepse moral politik le të ju mbajë Kryetari, drejtorave të vetë që në binë në Kuvend propozime të tilla.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Dha pauzë njëorëshe për drekë në ora 12:50h.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Vazhdoi mbledhjen në ora 13:40h po vazhdojmë mbledhjen për pikën e 9, hapi diskutimin.

z.Asllan Beqaj; Ne po kërkojmë që të mbajmë një diskutim të mirëfilltë për ndërtimin e Çerdhes për fëmijë në lokacionin në të cilin legjislatura e mëparshme e ka ndërtuar ambulancën e fshatit Petrovë.

z.Përparim Ramusa; Banorët e fshatit e kanë pranuar ambulancën në fshatin Petrovë dhe nuk ka pasur ankesa. Unë propozoj që ta shtyejmë këtë pikë për mbledhjen e radhës.

z.Rexhep Gashi; Është për ta përshendetur mundësin e ndërtimit të Çerdheve të fëmijëve. Nuk e di kush është kunder. Siq e dini në këtë sallë të Kuvendit ne kemi pas telashe të mëdha me një objekt për të pame në fshatin Petrovë, kjo ka ndodhë sepse atëherë pozita nuk ka dhënë sqarimet e nevojshme prandaj edhe kan dalë probleme të mëdha. Për këtë arsye unë mendoj se është e nevojshme që të ipen sqarimet e nevojshme, prandaj propozoj që sot ta shtyejmë këtë pikë me qëllim ta kemi më të qartë se qfar vendimi do të marrim.

z.Asllan Beqaj; Unë propozoj që ta ndajmë lokacionin për Çerdhen në fshatin Godanc dhe ta aprovojmë këtë vendim, ndërkaq për fshatin Petrovë mundë të diskutojmë për lokacionin e duhur.

z.Përparim Ramusa; Unë po propozoj që kjo të shtyhet, të na sillni 4 projektet e Çerdheve dhe ne do ti votojmë.

z.Rrahman Jakupi; Unë kam një pyetje se kush e finanson projektin?

Kryetari, z.Qemajl Aliu; Është projekt qeveritar, kur prej neve kërkohet miratimi i vendimit për caktimin e lokacioneve për ndërtimin e qerdheve. Nëse po kërkohet që të shtyhet për fshatin Petrovë të shterrimit të mundësive për diskutim me banorët e fshatit, në Godancë nuk është kjo dilemë diskutimi është kryer prona është e jona-Komunale kështu që aty nuk ka asnjë kontest, prandaj unë mendoj se për fshatin Godanc Kuvendi mundë ta miratojë vendimin.

z.Reshat Mujota; Pajtohem me ndërtimin e Çerdheve mendoj se nuk ka rëndësi nëse një ose dy muaj mundë të shtyhet pak më vonë. Sa i përket Çerdhës në fshatin Muzeqinë unë mendoj se nuk ka qka vjen në Kuvend, sepse sa e di unë është një objekt që ka mundësi të adaptohet dhe lokacioni është i Komunës.

Kryetari, z.Qemajl Aliu; Siq e dini Qeveria e Kosovës ka premtuar ndërtimin e 50 Çerdheve për gjithë Kosovën, kështu që edhe ne si Komunë jemi në një llojë gare se kush po bën përgaditjet më

mirë dhe më shpejtë, prandaj ne po përpiqemi që sa më parë ti plotësojmë kushtet dhe kriteret për ndërtimin e këtyre Çerdheve në Komunën tonë.

znj. Adelina Beqaj; Për sa i përket fshatit Petrovë mendojë se këtu është shterr debati. Ndërsa sa i përket debatit në fshat aty nuk kanë qenë 28 persona por 12 dhe 11 prej tyre kanë qenë “për” dhe 1 ka qenë “kundër”. Për Kryetarin e kam një pyetje se a ka pas debat publik në fshatin Godanc.

Kryetari, z. Qemaj Aliu; Po ka pasë debat publik me banorët dhe mundë të them se e kanë mirëprit këtë projekt dhe e kanë përkrahur njëzëri.

z. Reshat Mujota; Unë e thash se jamë “Për” dhe jam në gjendje që të vi në mbledhje dhe do ta votoj edhe sikur ta thirrni një mbledhje të jashtëzakonshme për këtë çështje. Mendoj se është dashtë me na ardhur procesverbali nga mbledhja e debatit publik me banorët e fshatit Petrovë.

znj. Sanije Sadiki; Opozita e tanishme, që 20 vite më parë sa kanë qenë në pushtet e kanë degraduar komunën e Shtimes, dhe tani këtu në Kuvend vijnë e na shesin moral politik, për ndërtimin e Çerdheve për fëmijë.

z. Përparim Ramusa; Kjo nuk ka kuptim, në këtë vend janë ndërtuar Çerdhe, rrugë e infrastrukturë tjetër dhe nuk mund të thuhet kështu.

z. Kadri Emini; Shumë shkurt, e kuptoj që lokacioni në fshatin Petrovë është i dyshimt, dhe le ta shtyejmë këtë me qëllim që ta konstatojmë sakt lokacioni dhe pronësia sepse ka pas rast që qeveria e kaluar ka ndërtuar shkollë fillore në fshatin Lagja e Pajtimit në një pronë private, dhe pastaj Komunës kjo i ka kushtuar mbi 1 milion euro. Unë po kërkoj që vendimi për Çerdhe në fshatin Godanc me kaluar ndërsa në fshatin Petrovë të bëhet debat me banorët të gjendet lokacioni i përshtatshëm dhe pastaj të vendosim si Kuvend.

Kryesuesi, z. Adnan Ademi; Sa i përket afërsisë të varrezave pranë Çerdhes mundë të them edhe te Çerdhja e sotme në Shtime që është ndërtuar tash frik është shumë afër varrezave, por pa marrë parasysh unë jam që sot ta miratojmë vendimin për Çerdhen në fshatin Godanc ndërsa për fshatin Petrovë ta shterrim debatin me banorët e fshatit.

z. Rrahman Jakupi; Pse duhet me bë debat publik në fshatin Petrovë, e pse jo në Godanc.

Kryesuesi, z. Adnan Ademi; Konstatoi, Kuorumin prej 20 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

***Kuvendi i Komunës, unanimitisht vendosi që pjesa e pikës së 9 (nëntë) të rendit të ditës “Propozim-Vendim për caktimin e lokacionit për Çerdhe në fshatin Petrovë”, të shtyhet për shqyrtim, deri në mbledhjen e radhës, dhe të organizohet debat publik me qytetarë për gjetjen e një lokacioni të përshtatshëm.**

***Kuvendi i Komunës, me 19 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim” miratoi vendimin për ndarjen e truallit (oborr) për ndërtimin e Çerdhes për Fëmijë në fshatin Godanc i Poshtëm, me sipërfaqe prej: 00.13.00 (trembëdhjetë ari), në pjesën e ngastrës kadastrale me numër: P-72809027-00374-1, Zona Kadastrale, Godanc i Poshtëm, Evidentuar, Pronë e Kuvendit Komunal-Shtime.**

Pika 10

Propozim-Plani Lokal i Verprimit për Biodiversitet 2021-2026

Kryesuesi, z. Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z. Përparim Ramusa; Kërkojë nga drejtori për Shërbime Publike që të na elaborojë pak këtë pikë.

z. Bardhyl Rushiti, drejtor i DSHP; Përshtet, unë nuk kam qka të shtojë më shumë se sa që e keni marrë dokumentin dhe e keni lexuar. Është një dokument që ka filluar më herët. Bazën ligjore e keni në dokument, nëse ka ndonjë pyetje do të mundohem të përgjigjem ju ftoj që ta aprovoni.

z. Hamëz Tërshani; Unë jam që ky plan i veprimit të aprovohet.

znj. Adelina Beqaj; Unë mendojë se ky plan i veprimit duhet të shkojë në diskutim publik.

Kryesuesi, z. Adnan Ademi; Konstatoi, Kuorumin prej 19 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

***Kuvendi Komunës, unanimitisht miratoi Vendimin për ta nxjerrë në Diskutim Publik, Propozim-Planin Lokal të Verprimit për Biodiversitet 2021-2026, për afatin prej 15 ditësh. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Drejtorja për Shërbime Publike në bashkëpunim me Zyrën për Informim.**

Pika 11

Informatë e përgjithshme nga Drejtorja për Zhvillim Ekonomik

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha Kastriot Shabani.

z.Kastriot Shabani, drejtor i Zhvillimit Ekonomik; Pasi që përshëndeti të gjithë të pranishmit, lexoi dokumentin e informatës (shih dokumentin). Dokumentin e keni marrë me kohë dhe besojë e keni lexuar kështu që i mirëpres pyetjet e juaja.

z.Përparim Ramusa; Kjo informatë nuk votohet, por kam disa pyetje 1. Ku e dini ju drejtor që firma “Kopshti Gimi” ka falimentuar? 2.Sa kam parë unë ju drejtor keni qenë për vizitë në Maqedoni me Kryetarin a keni qenë atje për përhapje a për çka keni qenë?

z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE; Tash jemi duke vazhduar në fazën e fundit me projektet që kan qenë të vitit të kaluar 2021 ku ndër projektet që kam pas në drejtorinë time kanë qenë operatorë ekonomik “Kopshti Gimi” ku ka qenë faza e katërt e punimeve të Pishat, dhe nuk i ka filluar punimet dhe me një e-mail e ka njoftuar drejtorinë e prokurimit që e ka shpallur falimentimin e firmës. Në Maqedoni kemi shkuar me Kryetarin për bashkëpunim me Komunitet tjerë në projektin IPA-së, sepse kemi me aplikuar në një projekt të përbashkët.

znj.Rrezartë Ramadani; A mundë ti permendeni se cilat projekte janë ndërprerë? Projekti i tregut të gjelbërt deri ku ka arrit?

z.Hamëz Tërshani; Faleminderit për informatën. Dua ta di takimi me KEDS-in, qka keni biseduar me ta?

z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE; Informatat më të sakta mundë ti merrni nga drejtorja e Prokurimit.

z.Muhamet Ademaj; Me 12.07.2018 Kuvendi ka marrë vendim për shpalljen e zonës ekonomike në fshatin Gllavicë, pyetja është pse nuk ka filluar kompletimi i infrastrukturës.


z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE; Ne kemi konkuruar me dokumentacion në Ministrinë përkatëse dhe tani po presim një përgjigje nga Ministria.

z.Besnik Seferi; E falenderojë drejtorin për bashkëpunim me OJQ-në “Help”. Në vitin 2021 ka pas vërshime të mëdha në Komunën tonë, a ka pas kërkesa për kompensim dhe sa është mundësia për me i mbuluar dëmet e shkaktuara nga vërshimet.

z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE; Unë me marrjen e detyrës i kam pasë 5 kërkesa të tilla dhe të gjitha i kemi adresuar në Ministrinë e Bujqësis, tani është në kompetencën e tyre që ti procesojnë këto kërkesa.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesi mbledhjen e përfundoj në ora 14:44h.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi

